



## FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE

### Departamenti i Shkencave Sociale

Me rastin e ditës botërore të filozofisë, në datën 20 nëntor 2015, Departamenti i Shkencave Sociale, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, organizoi Seminarin me temë:

**“Filozofia dhe shkolla, probleme dhe sfida”.**

Në traditën e aktiviteteve shkencore të këtij departamenti, Dita e Filozofisë ka patur në fokus refleksione dhe debate mbi çështjet bashkëkohore që kanë në qendër mendimin dhe analizat filozofike.

Në këtë seminar, pedagogë, mësues dhe studentë nënvizuan rëndësinë dhe rolin e filozofisë në edukimin dhe formimin kulturor të individit. Dekani i fakultetit, Prof. dr. Gjergji Pendavinji, në fjalën e tij, trajtoi filozofinë për fëmijë si një risi dhe sfida e sistemit të edukimit në vendin tonë. Çështjet që u shtruan për diskutim në këtë seminar zgjuan interesin e të ftuarve.



### Programi i seminarit:

Fjala e hapjes, Dekani i FSHNH-së, **Prof dr. Gjergji PENDAVINJI**

1. **Prof. dr. Gjergji PENDAVINJI, doktorante Ina ZALLEMI:** “*Filozofia për fëmijë dhe diskutimi me synim filozofik*”. (DSF)
2. **Tefta TAKO:** “*Ç’mimizimi i filozofisë si “lëndë e vështirë” dhe impakti i saj ndërdisiplinar*”.
3. **Bernadette De Oliveira Martins:** “*Përvoja franceze në mësimin e filozofisë*”.
4. **Doktorant Jordan JORGJI:** “*Vendi i filozofisë në shkollën e sotme të dijes. Disa përvoja europiane*”.
5. **Doktorant Eriseld KALEMAJ, Doc. Ardian MATKA:** “*Konteksti bashkëkohor dhe nevoja për një filozofi të aktualitetit*”.
6. **Msc. Viola DOLANI, doktorante Suela IBRAIMLLARI, doktorante Mitjana PROFIRI:** “*Dija filozofike si një mënyrë jetese*”.
7. **Doktorant Alket DINO:** “*Filozofia dhe shoqëria*”.
8. **Margeta PILURI, Ervis LILO (studentë):** “*Filozofia dhe formimi i mendimit tek studentët*”.

